



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

7789.
Nr....Prot

Tiranë, 01.08.2016

UDHËZIM

Nr. 15, datë 01/08/2016

“PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.13, DT.22.07.2016 “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE MË KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016 -2017””

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 01.6.2016 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”,

UDHËZOJ:

Pas Kreut IV të udhëzimit nr.13, dt.22.07.2016, shtohet Kreu IV/1, si më poshtë:

1. Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL të vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë IAL-të.
2. Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Rregjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.
3. Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-së përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen AKP-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon AKP-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.

4. Rregjistrimi si student i kandidatëve fitues nga AKP-ja, kryhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor. Pas përfundimit të njohjes, AKP-ja kryen rregjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës 20 janar 2017 ja komunikon IAL-së.
5. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe *programi i përbashkët* i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4 të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

